Fjala e Paqes

Mbi krye ia vunë shkresën e arsyes së dënimit: "ky është Jezusi, mbreti i judenjve".

(Mt. 27,37)

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult Nr. 6 (137) Viti XIX Tetor - Nentor 2017

PAPA FRANÇESKU

PËR NJË BOTË TË LIRË PREJ ARMËVE BËRTHAMORE

Fjalimi i Atit të Shenjtë Françeskut drejtuar pjesëmarrësve në Kuvendin «Perspektiva për një botë të lirë prej armëve bërthamore dhe për çarmatimin e plotë» Salla Klementina
E premte, 10 nëntor 2017:

Të dashur miq,

i drejtoj secilit prej jush përshëndetjen time të përzemërt dhe shpreh mirënjohje të gjallë për praninë tuaj e për veprimtarinë tuaj në shërbim të së mirës së përbashkët. Falënderoj Kardinalin Turkson për fjalët përshëndetëse dhe hyrëse.

Keni ardhur në këtë Simpozium për të përballuar argumente kyçe, si në vetvete, si në konsiderim të kompleksitetit të sfidave politike të skenarit aktual ndërkombëtar, të karakterizuar nga një klimë e paqëndrueshme konfliktualiteti. Një pesimizëm i errët mund të na nxisë të mendojmë se «perspektivat për një botë të lirë prej armëve bërthamore dhe për një çarmatim të plotë», siç thotë titulli i takimit tonë, duken gjithnjë e më të largëta. Është fakt se spiralja e armatimit nuk njeh pushim dhe se kostot e modernizimit dhe zhvillimit të armëve, jo vetëm bërthamore, përfaqësojnë një zë të konsiderueshëm shpenzimi për kombet, deri në atë pikë sa t'i vënë në plan të dytë parësitë reale të njerëzimit që vuan: luftën kundër varfërisë, nxitjen e paqes, realizimin e projekteve edukative, ekologjike e shëndetësore dhe zhvillimin e të drejtave njerëzore.[1]

Pastaj, nuk mund të mos provojmë një ndjenjë të gjallë shqetësimi nëse marrim parasysh rrjedhojat katastrofike humanitare e mjedisore që rrjedhin nga çfarëdo përdorimi i mekanizmave bërthamorë. Prandaj, edhe duke marrë parasysh rrezikun e një aktivizimi aksidental të këtyre armëve për arsye të një gabimi të çfarëdo lloji, duhet dënuar me vendosmëri kërcënimi i përdorimit të tyre, si edhe vetë zotërimi i tyre, pikërisht sepse ekzistenca e tyre lidhet me një logjikë frike që nuk ka të bëjë vetëm me palët në konflikt, por me krejt gjininë njerëzore. Marrëdhëniet ndërkombëtare nuk mund të jenë të zotëruara nga forca ushtarake, nga frikësimet e ndërsjellta, nga paraqitja e arsenaleve të luftës. Armët e shkatërrimit në masë, veçanërisht ato atomike, nuk krijojnë tjetër gjë veçse një ndjenjë mashtruese sigurie dhe nuk mund të ndërtojnë bazat e bashkëjetesës paqësore mes anëtarëve të familjes njerëzore, e cila duhet të frymëzohet nga një etikë solidariteti.[2] Nga ky këndvështrim, e pazëvendësueshme është dëshmia e *Hibakusha*-ve, pra e personave të goditur nga shpërthimet e Hiroshimës e Nagasakit, ashtu si edhe ajo e viktimave të tjera të eksperimenteve të armëve bërthamore: zëri i tyre profetik qoftë një paralajmërim sidomos për brezat e rinj!

Gjithashtu, armatimet që kanë si efekt shkatërrimin e gjinisë njerëzore janë edhe ilogjike në planin ushtarak. Në fund të fundit, shkenca e vërtetë është gjithmonë në shërbim të njeriut, ndërsa shoqëria bashkëkohore duket si e trullosur nga devijimet e projekteve të konceptuara në gjirin e saj, ndoshta për një çështje të mirë në origjinë. Mjafton të mendojmë se teknologjitë bërthamore po përhapen tashmë edhe nëpërmjet komunikimeve telematike dhe se mjetet e së drejtës ndërkombëtare nuk kanë penguar që Shtetet të reja t'i shtoheshin rrethit të zotëruesve të armëve atomike. Bëhet fjalë për skenare të ankthshme po të mendojmë për sfidat e gjeopolitikës bashkëkohore si terrorizmi apo konfliktet asimetrike.

E pra, një realizëm i shëndoshë nuk resht së ndezuri mbi botën tonë të çrregullt dritat e shpresës. Kohët e fundit, për shembull, nëpërmjet një votimi historik në OKB, pjesa më e madhe e Anëtarëve të Bashkësisë Ndërkombëtare ka përcaktuar se armët bërthamore nuk janë vetëm imorale por edhe duhet të konsiderohen një mjet i paligjshëm lufte. Kështu është mbushur një zbrazëtirë juridike e rëndësishme, meqenëse armët kimike, ato biologjike, minat antinjeri dhe bombat vile janë të gjitha armatime shprehimisht të ndaluara nëpërmjet Konventave ndërkombëtare. Edhe më domethënës është fakti se këto rezultate i detyrohen kryesisht një «*nisme humanitare*» të nxitur nga një aleancë e vlefshme mes shoqërisë civile, Shteteve, Organizatave ndërkombëtare, Kishave, Akademive dhe grupeve të ekspertëve. Në këtë kontekst vendoset edhe dokumenti që ju, të nderuar me Çmimin Nobel për Paqen, më keni dorëzuar dhe për të cilin shpreh vlerësimin tim plot mirënjohje.

Pikërisht në këtë 2017 i bie 50-vjetori i Letrës *Enciklike Populorum* progressio e Palit VI. i Paolo VI. Ajo, duke zhvilluar vizionin e krishterë të personit, ka vënë në dukje nocionin e zhvillimit njerëzor të tërësishëm dhe e ka propozuar si emër të ri të paqes. Në këtë Dokument të jashtëzakonshëm dhe shumë aktual Papa ka dhënë formulën e përmbledhur e të përsosur për të cilën «zhvillimi nuk kufizohet thjesht në rritjen ekonomike. Për të qenë një zhvillim i njëmendtë, duhet të jetë i tërësishëm, gjë që do të thotë se duhet të jetë i prirur nga promovimi i çdo njeriu dhe i gjithë njeriut» (nr. 14).

Pra, para së gjithash duhet të mos e pranojmë kulturën e skartimit dhe të kemi kujdes për personat e për popujt që vuajnë pabarazitë më të

Vijon në fq. 2

PAPA FRANÇESKU
PËR NJË BOTË TË LIRË PREJ ARMËVE BËRTHAMORE

Vijim i fq. 1

dhimbshme, nëpërmjet një vepre që di të privilegjojë me durim proceset solidare në vend të egoizmit të interesave dytësore. Njëkohësisht bëhet fjalë për të integruar dimensionin individual dhe atë shoqëror nëpërmjet zhvillimit të parimit të subsidiaritetit, duke favorizuar ndihmesën e të gjithëve si individë dhe si grupe. Së fundit, duhet të nxitet njerëzorja në njësinë e vet të pandashme si shpirt e trup, si soditje dhe veprim.

Ja, pra, se si një përparim efektiv dhe përfshirës mund ta bëjë të aktualizueshme utopinë e një bote pa mjete sulmi vdekjeprurës, pavarësisht prej kritikës së atyre që i konsiderojnë si idealiste proceset e shkatërrimit të arsenaleve. Mbetet gjithnjë i vlefshëm magjisteri i Gjonit XXIII, që e ka treguar me qartësi objektivin e një çarmatimi të tërësishëm duke pohuar: «Ndalimi i armatimeve me qëllime luftarake, pakësimi i tyre efektiv, dhe, aq më tepër, zhdukja e tyre janë të pamundshëm ose pothuajse të tillë, nëse në të njëjtën kohë nuk vazhdohet me një çarmatim të tërësishëm; pra, nëse nuk çarmatohen edhe shpirtrat, duke u angazhuar sinqerisht për ta zhdukur, në ta, psikozën e luftës» (Let. enc. *Pacem in terris*, 11 prill 1963, 61).

Kisha nuk lodhet së ofruari botës këtë urti dhe veprat që ajo frymëzon, me vetëdijen se zhvillimi i tërësishëm është rruga e së mirës që familja njerëzore është e thirrur të përshkojë. Ju nxis që ta çoni përpara këtë veprim me durim e qëndresë, me besimin se Zoti na shoqëron. Ai e bekoftë secilin prej jush dhe punën që kryen në shërbim të drejtësisë e të paqes. Faleminderit.

Nga www. vatican.va

MESAZHI FINAL CCEE – NGA MINSK – BIELORUSSIA

Nga 27 shtator deri 1 tetor 2017 u mbajt në Minsk të Biellorusisë Asamblea e Zakonshme e Konferencës Ipeshkvnore të Europës (CCEE).

Në vijim mesazhi përfundimtar:

Kisha e do Evropën dhe beson tek e ardhmja e saj: Evropa nuk është vetëm një tokë, por është një detyrë shpirtërore. Në mbledhjen plenare që është mbajtur në Minsk (Bjellorusi), kemi ripërtërirë angazhimin tonë për të marrë pjesë me entuziazëm në rrugëtimin e Kontinentit, që ka diçka të madhe për t'i dhuruar të gjithëve në logjikën e reciprocitetit. Detyra e Këshillit tonë është të promovojmë bashkimin mes Barinjve të Kombeve të ndryshe, si dhe të gjejmë rrugët që zëri i Zotit Jezus të tingëllojë sërish në zemër të "njeriut evropian", të kulturës dhe të shoqërisë: dinjiteti njerëzor ku tjetër mund të ankorohet fort nëse jo në Jezusin birin e Hyjit të bërë njeri? Ky është kontributi specifik i Krishterimit në identitetin evropian dhe dymijë vite dashuri vepruese, art, kulturë, janë dëshmi e gjallë. Me shumë dashuri, e bëjmë tonën shpresën e Atit të Shenjtë Françesk për "një hov të ri dhe të guximshëm për këtë Kontinent të dashur".

Në këtë hov s'mund të mungojmë, të vetëdijshëm se jemi lajmëtarë të një lajmi të gëzueshëm. Mesazhi për të cilin i jemi botës borxhli është i madh dhe i fortë, por me instrumente të varfra: Ungjilli i Jezusit është burimi i përhershëm i historisë evropiane, i qytetërimit të saj human, i demokracisë, i të drejtave dhe detyrimeve njerëzore. Ashtu sikurse është edhe garancia më e sigurt! Pavarësisht shtytjeve që synojnë ta izolojnë, besojmë tek ai njesim (unitet, bashkim) idealesh shpirtërore dhe etike që gjithmonë është shpirti dhe fati i Evropës. Ashtu sikurse besojmë në një rrugëtim të vazhdueshëm pajtimi që është pjesë jo vetëm e historisë, por edhe e jetës, dhe që të shpie në respektimin dhe vlerësimin e traditave të ndryshme dhe religjioneve përtej çdo ekstremizmi.

Hapja ndaj religjionit, ndaj Trashendencës, ndaj relacionit solid, ndaj bashkimit, fytyrën e kanë marrë në Ungjill dhe kanë zbuluar dinjitetin e vetëm (unik) të njeriut; kanë frymëzuar rrugëtimin jo gjithmonë të lehtë të Evropës që ka parë edhe caqe (limite) dhe gabime. I njëjti fenomen i emigrimit është i shndritur nga ky shpirt, në shenjën e pranimit, të integrimit dhe të ligjshmërisë, pavarësisht vështirësive dhe frikësimeve, të vetëdijshëm për përpjekjen e domosdoshme të një përgjegjësie të përbashkët. Popujve dhe Kombeve u shprehim inkurajimin tonë për të reaguar edhe ndaj sugjestioneve (magjepsjeve) të shekullarizimit, që të shtyn të jetosh pa Zot ose ta kufizosh në hapësirën private, duke ushqyer embrionin e individualizmit dhe duke prodhuar vetmi.

Përveç kësaj, dihet se hapja ndaj jetës – në çdo fazë të sajën – është një tregues shprese dhe shkalla e lindjeve është shenja më e mirë e gjendjes së shëndetit në shoqëri. Bash realiteti rinor – temë e Sinodit të ardhshëm të Kishës – ka qenë tema tjetër e vëmendjes (përkujdesit) tonë kolegjial. Një simpati e madhe ka dalë nga Espikopatet Evropiane: simpati që përkthehet në lutje, afërsi më të madhe, dëshirë dëgjimi dhe shoqërimi të durueshëm dhe të dashur të rinisë.

Kisha beson fort në të rinjtë, ka respekt e besim, sikurse një nënë për bijtë e saj. Gjatë punimeve, kanë dalë disa shqetësime, sikurse kultura e lëngshme që të gjithë thithim, pezmatimi individualist i përhapur që prodhon pasiguri dhe vetmi, si dhe disa konflikte dhe padrejtësi që akoma sot dëmtojnë të mirën e madhe të paqes. Janë motive që dëshmojnë angazhimin tonë për t'u qëndruar afër dhe për të ecur me ta; që t'ua bëjmë të ditur se Ungjilli është shpallja e madhe e "po-së" së jetës, dashurisë, lirisë, gëzimit: është t'i thuash "po" Krishtit. Në këtë rrugë bashkësitë tona janë me ne dhe me meshtarët tanë, për të qenë shenjë shprese, bashkimi, bujarie aktive: rrënja e gjallë dhe e thellë është Krishti, që i flet zemrës dhe arsyes së gjithkujt sikurse edhe Kontinentit, që të gjejë sërish vetveten përtej politikës dhe ekonomisë.

Do donim që fjala e Jezusit të arrinte zemrën e Evropës: "Mos ki frikë, unë jam me ty". Evropë e lashtë, mos ki frikë të jesh vetvetja, merre sërish rrugën e Etërve që të kanë ëndërruar si shtëpi Popujsh dhe Kombesh, nënë e frytshme me bij dhe me qytetërim, tokë humanizmi të hapur dhe të plotë. Po, mos ki frikë, ki besim! Kisha, eksperte në njerëzim, është shoqe: me shikimin e drejtuar tek Krishti dhe në dorë Ungjillin, ecën me ty drejt të ardhmes së pajtimit, drejtësisë dhe paqes.

PËRVJETORI I PARË I LUMNIMIT TË MARTIRËVE TANË

(…)kanë qenë dëshmitarë të Krishtit në jetën e tyre të zakonshme si laikë, meshtarë, rregulltarë apo ipeshkvinj; e kanë dëshmuar edhe më shumë gjatë diskutimeve të "proceseve-farsë" të organizuara nga urrejtja ateiste; e kanë dëshmuar deri në maksimumin e mundësive të tyre me vdekjen heroike.

(…)Nëse i shohim ata si arsye krenarie, kemi dështuar plotësisht në objektivin që t'i shihnim të lartësuar në nderet e altareve; por nëse i shohim ata si modele të jetës së krishterë dhe të angazhimit shoqëror për të mirën e kombit tonë, atëherë i bëjmë një nder vetvetes dhe krejt kombit të cilit i përkasim. Vetvetes sepse do të jemi të krishterë më të mirë; kombit sepse, besnikë ndaj Ungjillit, do të ndihmojmë në ringritjen morale të Kombit.

Në 4 nëntorin e kaluar, me këto fjalë, së bashku me thirrjen e drejtuar gjithë popullit shqiptar për të mos ikur por për të qëndruar në atdhe, si dhe institucioneve që të krijojnë kushtet për një të ardhme më të mirë, Imzot Angelo Massafra ka dashur të kremtojë përkujtimin e përvjetorit të parë të Lumnimit të Imzot Vinçenc Prennushit dhe 37 Shokëve, Martirë të Shqipërisë në Kishën Katedrale të Shkodrës.

Një kremtim i thjeshtë dhe solemn në të njëjtën kohë, në të cilin morën pjesë të gjithë ipeshkvinjtë e Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi, përveç meshtarëve e rregulltarëve të mbledhur me këtë rast, gjatë të cilit u ndie një klimë e madhe lutjeje që, përveçse nderoi siç duhet të Lumët Martirë, ndihmoi edhe që të jetohej një moment vëllazërie kishtare të mrekullueshme.

I transmetuar drejtpërdrejt nga një televizion lokal dhe i ndjekur edhe nga rrjetet më të mëdha sociale shqiptare, kremtimi i animua nga Kori i Konferencës Ipeshkvore Shqiptare i përbërë nga 80 elementë, një risi e Kishës në Shqipëri, pas veprimtarive formuese në fushën liturgjike-muzikore të dëshiruara nga vetë Konferenca.

Në përfundim të kremtimit, urna me reliket e Martirëve, që më parë ishte ekspozuar në presbiterium, u çua solemnisht në Altarin e kushtuar atyre ndërkohë që po këndohej Himni zyrtar i Lumnimit; dhe aty u tha lutja për Kanonizimin e tyre, në pritje që Mëshira e Hyjit të bëjë, me ndërmjetësinë e tyre të përbashkët, ndonjë mrekulli që të na lejojë t'i shohim një ditë të shpallur Shenjtër të Kishës së gjithëmbarshme.

Çdo Dioqezë e Shqipërisë kujtoi pastaj përvjetorin e Lumnimit të dielën më 5 nëntor dhe çdo Famulli kremtoi përkujtimin liturgjik të tij ditën tjetër.

Tani në vijim Homelia e Imzot Massafrës:

"Kush të qëndrojë deri në fund, ai do të shëlbohet".

E kënduam në rreshtin e alulujës dhe e dëgjuam prej gojës së Jezusit në fjalët e fundit të Ungjillit të sapo shpallur.

Vëllezër e motra,
bashkëvëllezër ipeshkvinj,
meshtarë e diakonë,
rregulltare e rregulltarë,
Autoritete Civile e Fetare
të mbledhur këtu për të kujtuar, përreth tryezës së Fjalës dhe të Eukaristisë, ngjarjen e Lumnimit të Imzot Vinçenc Prennushit dhe 37 Shokëve, Martirë: kjo vërejtje e Jezusit që e dëgjuam na lejon ta jetojmë këtë ditë sipas perspektivës së duhur, duke shkuar, në njëfarë kuptimi, prapa në kohë.

Kujtojmë shpalljen e tyre të Lumë të Kishës, por pa harruar përse-në. Sepse, pikërisht, kanë qëndruar deri në fund: kanë qenë dëshmitarë të Krishtit në jetën e tyre të zakonshme si laikë, meshtarë, rregulltarë apo

ipeshkvinj; e kanë dëshmuar edhe më shumë gjatë diskutimeve të "proceseve-farsë" të organizuara nga urrejtja ateiste; e kanë dëshmuar deri në maksimumin e mundësive të tyre me vdekjen heroike.

E nëse duhet t'u rrimë gjithnjë fjalëve që Jezusi ka thënë në Ungjill, duhet të themi edhe se ata kanë qenë gjithmonë të ngjeshur me Shpirtin Shenjt që i ka bërë të ngjashëm me Krishtin në shprehjet e ndryshme që kanë karakterizuar kalimin e Tij në këtë tokë. Kanë jetuar në varfëri në imitim të Zotit të tyre dhe në bashkëndarje me popullin; kanë mësuar dhe përçuar fenë sikurse Jezusi Mësues; kanë praktikuar dashurinë e krishterë në imitim të Samaritanit hyjnor; kanë sjellë paqen, Princi i së cilës është Jezusi; në çdo mundim nuk i kanë hequr sytë prej "Njeriut të dhimbjeve, të regjur me vuajtje" (Is 53,3); e pasi e kanë takuar në Lavdi, tani bashkëndajnë me Të Lumninë e Qiellit.

Shenjtër në tokë? Jo, të dashur vëllezër e motra. Të krishterë të thjeshtë të angazhuar, shumë të dashuruar me Krishtin dhe me Ungjillin e tij. Duke vështruar ata mund të vërejmë një model shumë aktual të të qenurit Kishë e gjallë. Imitimi i Krishtit që ata kanë zbatuar është i mundshëm edhe për ne. Nuk kemi nevojë për formula të mëdha baritore që ta përtërijmë Kishën tonë; ajo për të cilën kemi me të vërtetë nevojë është të jetojmë dhe të ushqejmë të bërit tonë të ngjashëm me Krishtin.

Nëse çdo i pagëzuar do të ishte me të vërtetë një "alter Christus" (Krishti tjetër), atëherë Kisha jonë do të ishte një Kishë e

Vijon në fq. 4

PËRVJETORI I PARË I LUMNIMIT TË MARTIRËVE TANË

Vijim i fq. 3

gjallë, e aftë për të shpallur e dëshmuar, për të takuar njeriun ku jeton dhe për të qenë kishë gjithmonë në dalje, sikurse e dëshiron Papa Françesku. Pra, mirë se të vijnë programet dhe projektet baritore, por që të lindin prej Ungjillit, për t'i bërë besimtarët të rriten dhe të arrijnë "masën që i përket pjekurisë së plotë të Krishtit" (Ef 4,13)

"Passio" e tyre (Mundimet e tyre) ka qenë edhe "Passio" (Mundimet e tyre) e një populli të tërë, popullit tonë, të privuar nga identiteti krejtësisht i përqenduar përreth binomit "Fe e Atdhe", të poshtëruar në mënyrë të skajshme: një vëllavrasje sistematike e graduale, etapat kryesore të së cilës i kanë shënuar kampionët tanë, tani të Lumë. Ata nuk kanë pranuar ta shpëtojnë lëkurën veç për të qëndruar e për të bashkëndarë fatin e popullit të tyre, të atij populli të cilit, në mënyrë të rremë, i ishte dhënë një pushtet që, në të vërtetë, ishte krejtësisht i përqendruar në duart e një njeriu të vetëm dhe që, për Martirët tanë, ka qenë një "Crucifige" e re (një Kryqizojë të ri), e ngjashme me britmën e hebrenjve përpara Pilatit.

Por, sikurse gjaku i Krishtit ka shpëtuar e shëlbuar edhe kryqëzuesit e tij, po ashtu gjaku i Martirëve tanë, i bashkuar me atë të Krishtit, vazhdon të jetë arsye shprese dhe shpëtimi për popullin tonë, sot pre e tiranive edhe më të rënda e tinëzare, përballë të cilave nevojitet një aftësi e madhe shoshitjeje dhe guximi për t'i paditur.

Vëllezër e motra, kampionët tanë të fesë e të atdheut, nuk ishin jashtëtokësorë por persona si ne, të krishterë të bindur për identitetin e tyre që nuk kanë lënë t'ua vjedhin dhe që nuk e kanë shkëmbyer në asnjë mënyrë. Prandaj, atë që e kemi përshkruar si virtyt që i ka dalluar në të qenurit dhe të vepruarit e tyre, mund të jetë edhe një virtyt i yni. Mjafton ta dëshirojmë dhe ta duam.

Nëse i shohim ata si arsye krenarie, kemi dështuar plotësisht në objektivin që t'i shihnim të lartësuar në nderet e altareve; por nëse i shohim ata si modele të jetës së krishterë dhe të angazhimit shoqëror për të mirën e kombit tonë, atëherë i bëjmë një nder vetvetes dhe krejt kombit të cilit i përkasim. Vetvetes sepse do të jemi të krishterë më të mirë; kombit sepse, besnikë ndaj Ungjillit, do të ndihmojmë në ringritjen morale të Kombit.

E dashur Shqipëri, diktatura komuniste të ka privuar prej shpirtit (dhe një trup pa shpirt është një trup i vdekur!). Vëllezër dhe motra, sot, 4 nëntor, përkujtojmë 27 vjetorin e Meshës së parë në varrezat katolike e kremtuar nga i ndjeri Don Simon Jubani. Procesi i rilindjes nuk ka qenë vetëm fryt i aleancave politike ndërkombëtare, por ka kaluar edhe e sidomos nëpërmjet ndërhyrjeve të frymëzuara nga Ungjilli, të atyre që në të gjitha këto vite të kanë ndihmuar për të të ridhënë dinjitet e bukuri. Sot, mjerisht, janë kapitalizmi dhe mirazhi i fitimeve të lehta, ashtu si edhe mosbesimi në Institucionet Politike që është duke shoqëruar një humbje të re të shpirtit: atë të të rinjve dhe të familjeve të tëra që parapëlqejnë ta lënë Atdheun për të kërkuar vende, ndër thonjëza, më të mira ku të gjejnë kushte jete më të volitshme.

Në emër të Martirëve tanë, dëshiroj t'u bëj sot një thirrje serioze e të përzemërt qytetarëve, familjeve, të rinjve, Institucionëve Qendrore dhe Lokale si dhe në mënyrë të veçantë të krishterëve katolikë: të krijojmë kushte më të mira jetese, të qëndrojmë fort në luftën kundër gjithçkaje që pengon zhvillimin dhe rritjen e popullit shqiptar, në radhë të parë korrupsioni dhe çdo qëndrim mafioz frikësimi ndaj atyre që duan të ndërtojnë dhe të realizojnë diçka të mirë për Vendin.

Ju kërkojmë me forcë: mos ikni, mos e lini Atdheun tuaj!

Në të njëjtën kohë, po i lejoj vetes t'u drejtoj një thirrje ne ipeshkvinjve, meshtarëve, rregulltarëve, të kushtuarve: të jemi më afër familjeve dhe sidomos të rinjve e adoleshentëve: t'u kushtojmë atyre gjithë kohën dhe energjitë e nevojshme, duke bashkëndarë nevojat e tyre, duke dëgjuar e dhënë kuptim ëndrrave dhe aspiratave të tyre, duke bërë gjithçka është e mundur që dëshira e tyre për realizim dhe për një të ardhme më të mirë të bëhet realitet.

Martirët tanë janë para nesh si modele të angazhimit dhe të guximit; jo vetëm kaq... por sot ata janë edhe ndërmjetësit tanë të fuqishëm dhe fitojnë për ne prej Hyjit ato hire të nevojshme për të jetuar mirë dhe për të punuar mirë në dobi të popullit tonë.

Guxim, Shqipëri! Në ty janë bukuria, natyra, burimet, mirësia dhe vlerat njerëzore e fetare. Je e pasur dhe nuk e di! Shiko brenda vetes, më shumë se sa të shohësh jashtë: aty do të zbulosh thesare të pamendueshme! Sepse Krijuesi nuk të ka braktisur, por sot, së bashku me të gjitha këto bukuri, është duke të të dhënë edhe mundësi të reja: jo ato që të ofrohen nga jashtë, por ato që Ai vetë i ka vënë brenda teje.

Për dhuratën e Imzot Vinçenc Prennushit dhe Shokëve Martirë, për dhuratën e Shenjtërimit të Nënë Terezës sonë, Hyjit të vetëm, Atit që të gjithë e adhurojmë, Krishtit Mbret e Zot të Gjithësisë, Shpirtit Shenjt e Shenjtërues, i qoftë nder, lavd e falënderim për të gjithë shekujt e shekujve. Amen.

MARTIRËT E LUME – LUTUNI PËR NE !

SHUGURIMI DIAKONAL I AKOLITIT JETMIR NIKOLLI

Gjithçka mundem me ndihmën e Atij që më jep fuqi (fil 4, 13)

Me 18 tetor, në festën e shën Lukës Ungjilltar, në Katedralen e Shkodrës, në praninë e shumë besimtarëve, Arqipeshkvi i Shkodër-Pultit, Angelo Massafra, më shuguroi diakon. Ishte sigurisht një ditë plot emocione jo vetëm sepse kisha shumë vite që përgatitesha për këtë moment por edhe sepse ishte momenti ku po i jepja një 'Po' përfundimtare Hyjit të jetës sime. Kur them përfundimtare nënkuptoj një 'Po' që jepet për gjithë jetën, por njëkohësisht bëhet fjalë për një 'Po' që duhet të përsëritet çdo ditë. Ky angazhim nuk vjen nga aftësitë e mia por nga fakti se Hyji më ka dashur i pari dhe është Ai që më jep fuqinë për të kryer vullnetin e Tij. Pikërisht mbi këtë gjë, Imzot Angelo, është ndalur gjatë predikimit. Ai i ka kujtuar bashkësisë, dhe mua si pjesë e bashkësisë, se jeta është një dhuratë dhe si e tillë ajo duhet të jetohet në shërbim. Diakonati duhet të jetë shërbim pa kushte. Diakoni është i thirrur ta jetojë këtë shërbim fillimisht duke shpallur dhe predikuar Fjalën e Zoti dhe, siç e theksoi Arqipeshvi gjatë homelisë, duhet të predikohet Krishti i vdekur dhe i ngjallur për ne. Sherbimi diakonal duhet të jetohet edhe në shërbimin e altarit, kujdesi për të varfërit dhe të sëmurët, dhënia e kungimit këtyre. Në mënyrë që

dëshmia e diakonit të jetë e vërtetë dhe e besueshme ai duhet të jetojë angazhimet që bëhen në ditën e shugurimit. Dhe në fakt ditën e shugurimit tim, ashtu si çdo diakon tjetër, kam premtuar se angazhohem që ta jetoj diakonatin në dashuri dhe përvujtëri në shërbim të Kishës, të ruaj misterin e fesë, ta shpall Ungjillin me fjalë dhe me vepra, jam angazhuar që me gjithë Kishën të lus me besnikëri Liturgjinë e Orëve, jam angazhuar që me ndihmën e Zotit t'i përngjaj Atij me jetën time dhe njëkohësisht i kam premtuar bindje bijësore Arqipeshkvit. Normalisht që të gjitha këto angazhime dhe premtime do të trembnin secilin që i merr përsipër me ndërgjegje të pastër por, duke iu besuar ndihmës që vetë Hyji më jep, kam thënë po ditën e shugurimit dhe atë po përpiqem ta jetoj në çdo moment prej asaj dite. Në përfundim të predikimit edhe Arqipeshkëvi më ka kujtuar të njëjtën gjë: ta dua Hyjin me zemër të pandarë.

Ndjenja që më ngelet nga ajo ditë është ndjenja e falënderimit Hyjit dhe Kishës së Tij për dhuratën e pamasë që më kanë dhënë. Dhe që këtë dhuratë ta jetoj dhe ta vendos në shërbim të Kishës së Hyjit duke iu besuar ndërmjetësimit të Zojës së Këshillit të Mirë, Shën Lukës Ungjilltar, të Lumëve Martirë të Shqipërisë dhe gjithashtu edhe lutjeve të popullit të Hyjit.

Dom Jetmir Nikolli

KARDINALI DOM ERNEST TROSHANI DHE IMZOT MASSAFRA NË BRESCIA -ITALI

Në ditët nga 12 deri më 15 tetor u mbajt në Breshia Festivali i Parë i Misionit italian i nxitur nga CEI (Konferenca Ipeshkvore Italiane), CIMI (Konferenca e Instituteve Misionare Italiane) dhe nga Dioqeza e Breshias, një rast për të folur për aktualitetin dhe për nevojën e misionit për jetën e Kishës. Qenë ditë feste dhe reflektimi... Më shumë se 15.000 persona u alternuan në veprimtaritë e ndryshme të propozuara sidomos në dëgjimin dhe në takimin me dëshmitarët e misionit. Gjatë Festivalit "Mission is possible" pati edhe një vëmendje domethënëse ndaj përvojës së Kishës në Shqipëri, të lidhur me dioqezën e Breshias për misionarët e pranishëm dhe sidomos për faktin se është toka ku ka lindur i Lumi Giovanni Fausti. Domethënëse qe edhe prania e Kard. Ernest Simonit dhe e Imzot Angelo Massafra-s gjatë gjithë kësaj ngjarjeje.

Kard. Ernesti pati mundësinë të vizitonte komunën e Markenos, vendlindja e atë Faustit, ku bekoi një portret të të lumit të vendosur në sallën kolegjiale dhe ku dha një dëshmi jete

Vijon në fq. 8

SHKOLLA KATOLIKE NË SHQIPËRI

Paraqitja e studimit te parë mbi edukimin katolik para universitare në Shqipëri në periudhën paskomuniste

1. Paraqitja e studim

Me datën 16 nëntor në ora 10.00Komisioni Kombëtar për Edukimin Katolik Shqiptar prezantoi në ambientet e Universitetit Zoja e Këshillit të Mirë në Tiranë,

Studimin mbi institucionet arsimore para universitare katolike në Shqipëri, rëndësinë dhe vlerat e shtuara që ato sjellin.

Në aktivitet ishin të pranishëm Nunci apostolik, Imzot Massafra, Imzot Frendo, Imzot Peragine, Zv Ministri i Arsimit, Zoti Demo, Sekretari i përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Edukimi Katolik OIEC, Zoti Philippe Richard, përfaqësues nga të gjitha komunitetet fetare, Kryetarja e Komitetit të KulteveZnjAliko, Rektori i universitetit Katolik, përfaqësues institucione të arsimit Izha dhe Isha, Drejtori i Caritasit Kombëtare dhe përfaqësues të Caritaseve të tjera, përfaqësues së Organizatave joqeveritare që kujdesen për edukimin, Drejtuesit e shkollave tona, Rregulltare e miq të edukimit, disa përfaqësues të Ambasadave, përfaqësi nga nxënësit dhe prindër.

Në fjalën përshëndetëse, Imzot AnxheloMasafra, President i këtij komisioni si edhe Kryetari i Konferencës Ipeshkvnore shqiptare, shprehu falënderimin e tij përpunën me përkushtim te komisionit dhe te shkollave, në funksion te edukimit.

Në këtë kontekst të ri, tha ai, ka rëndësi shumë të madhe angazhimi edukativ

që ne, shkollë katolike, synojmë të marrim si sfidë e cila nëse nga njëra anë na stimulon drejt njohjeve të dinamikave komunikuese dhe sociale të epokës në të cilën jetojmë, nga ana tjetër nuk duhet të na lërë të heqim dorë nga paraqitja e vlerave të lashta dhe gjithnjë aktuale të domosdoshme për formimin e personit njerëzor. Në fund Imzot Massafra në emër të Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare, falënderoitë gjithë ata që punojnë në një fushë të tillë të çmuar dhe delikate me shpresën se rezultatet e arritura, larg nga çdo formë e vetëkënaqësie, të nxisin më tepër angazhimin për të formuar brezat e rinj dhe kështu fytyra e Shqipërisë së re të ketë tiparet e bukurisë së përjetshme të diturisë dhe vlerave morale.

Zëvendësministri i arsimit, sportit dhe rinisë, ErvinDemovlerësoi kontributin e komunitetit katolik ne sjelljen e vlerave ne sistemin arsimor, por edhe ne ruajtjen, lëvrimin e gjuhës dhe traditave te folklorit.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga kryeministri Edi Ramapërmesnjë letre, dërguar Imzot Massafrës, ku vlerësoi angazhimin e Komitetit Kombetar te Edukimit Katolik Shqiptar, si edhe garantoi se gjetjet dhe rekomandimet e studimit do te konsiderohen e vlerësohen nga institucionet përkatëse si vlere e shtuar për t'i integruar ato ne agjendën reformuese te sistemit arsimor ne vend.

Pas paraqitjes së Studimit nga studiuesi Skerdi Zahaj, në debatin e shkurtër që u hapnw vijim, u diskutua mbi rekomandimet e dhëna prej studiuesve, të gjitha të mbështetura në gjetjet e Studimit.

Në vazhdim janë katër rekomandimet që Qendra Hap pas hapi, na bëri pas mbarimit të studimit:

Rekomandim 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe ngritja e mekanizmave për mbështetjen e edukimit dhe arsimimit të çdo fëmije, duke këmbëngulur në hartimin e buxhetit për çdo fëmijë. Në këtë mënyrë do të sigurohet që shkollat katolike të financohen nga shteti për arsimimin e qytetarëve shqiptarë.

Rekomandim 2: Nxitja e përfshirjes së fëmijëve me prejardhje vulnerabël dhe në zona të thella rurale, me qëllim ofrimin e mundësive të barabarta për arsimim dhe edukim të çdo fëmije, pavarësisht prejardhjes së tij/saj.

Rekomandim 3: Krijimi i mundësimit të bashkëpunimit mes institucioneve arsimore publike dhe atyre katolike, me

Vijon në fq. 7

SHKOLLA KATOLIKE NË SHQIPËRI

Vijim i fq. 6

qëllim përmirësimin e mundësive për një arsimim dhe edukim cilësor për çdo fëmijë. Ky bashkëpunim mund të shtrihet në të gjithë elementët përbërës të arsimimit: që nga mbështetja profesionale e mësuesve, te përmirësimi i kurrikulës me zgjedhje, tek ndarjet e përvojave të suksesshme për mbështetjen e nxënësve që të arrijnë rezultate më të larta në shkollë dhe të kenë dëshirë të përfshihen në shkollë. Për më tej, të krijohen mundësitë për studime të mëtejshme mbi analizimin më të thelluar të problematikave të përbashkëta dhe specifike të shkollave, me qëllim eksplorimin e rrugëve të mundshme për përballjen e sfidave në arsimin shqiptar.

Rekomandim 4: Eksplorimi i faktorëve që ndihmojnë në përmirësimin e marrëdhënies së fëmijës me shkollën, me të nxënit, me nxënësit e tjerë dhe me komunitetin në përgjithësi. Këta faktorë mund të ndihmojnë arsimin shqiptar në përmirësimin e marrëdhënies së nxënësve me shkollën, si element kyç në përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe të zhvillimit të vlerave qytetare të një shoqërie demokratike.

Studimin në detaje mund ta gjeni pas datës 27 nëntor në faqen zyrtare të Webit: www.edukimikatolik.al

Natyrisht studimi sapo ka mbaruar dhe i takon Këshillit drejtues dhe të gjithë rrjetit të edukimit katolik t'i studiojë, dhe të marrë në konsideratë rekomandimet dhe krejt studimit për t'i konkretizuar apo për t'i thelluar më tej. Në një farë mënyre duket se ecja, e filluar prej kohësh në fakt,është në një pikëzhvillimi përkah përmirësimi i cilësisë së edukimit.

Uroj që ky studim të na gjejë të hapur, të gjithëve ne që edukimin e kemi përzemër. Uroj që të na nxitë për të përmirësuar cilësinë e edukimit, që ta përmbushim kështu misionin tonë të shërbimit ndaj njeriut dhe ndaj së ardhmes, me bindjen se, edhe edukimi është një nga format më të larta të shprehjes së dashurisë për tjetrin.

Motër Teuta Buka,
Koordinatore Kombëtare
e Rrjetit të Edukimit
Katolik

PËRSHËNDETJA E IMZOT MASSAFRA

Të nderuar pjesëmarrës, është detyra ime t'ju uroj para së gjithash mirëseardhjen në këtë eveniment kaq të rëndësishëm siç është prezantimi i Studimit të Institucioneve arsimore parauniversitare katolike në Shqipëri.

Është i rëndësishëm sepse përshkruan aktivitetin e Kishës Katolike në dobi të edukimit dhe rritjes së brezave të rinj.

Fytyra e Shqipërisë po ndryshon dhe këtë e shohim të pasqyruar pikërisht në të rinjtë tanë, jo më të edukuar thjesht dhe vetëm në ambientin familjar ku shkolla përfaqësonte një mbështetje marxhinale, por tashmë në banka të nxitjeve të reja që vijnë nga bota e medias dhe komunikimit global.

Në këtë kontekst të ri ka rëndësi shumë të madhe angazhimi edukativ që ne, shkollë katolike, synojmë të marrim si sfidë e cila nëse nga njëra anë na stimulon drejt njohjeve të dinamikave komunikuese dhe sociale të epokës në të cilën jetojmë, nga ana tjetër nuk duhet të na lërë të heqim dorë nga paraqitja e vlerave të lashta dhe gjithnjë aktuale të domosdoshme për formimin e personit njerëzor.

Prandaj, në emër të Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare, do të doja të falënderoj të gjithë ata që punojnë në një fushë të tillë të çmuar dhe delikate dhe ata që do të ndërhyjnë gjatë këtij prezantimi të studimit të institucioneve arsimore para universitare katolike në Shqipëri, me shpresën se rezultatet e arritura, larg nga çdo formë e vetëkënaqësisë, të na nxisin më tepër në angazhimin për të formuar breza te rinj dhe kështu fytyra e Shqipërisë së re të ketë tiparet e bukurisë së përjetshme të diturisë dhe vlerave morale.

KUMTESA E PROF. DOM LORENZO ROSSETTI

«Edukimi katolik, kontributi i tij në edukimin tërësor në shërbim të njeriut, për një shoqëri të hapur, largpamëse dhe të begatë»

Cili është kontributi i edukimit katolik për shoqërinë civile, sidomos sot në Shqipëri? Do të zhvillojë këtë temë nga 3 pikëpamje:

1° pikëpamja sociologjike (domëthënie e misionit të Kishës brenda Shtetit);

2° pikëpamja morale (kontributi mbi vlerat);

3° pikëpamja historike (në nivel evropian dhe shqiptar).

1 / Pikëpamja sociologjike (raport Kisha-Shteti)

a) Pranimi i arsimit katolik është shenja e një Shteti demokratik.

Që të pranohet edukimi katolik tregon se Shteti nuk është totalitar; d.t.th. që ai respekton iniciativat e shoqërisë civile. Kjo përputhet me parimin e Subsidiaritetit: Shteti ndërhyn atje ku 'trupat ndërmjetme' (familjet, shoqatat, bashkësitë...) kanë nevojë për ndihmen e tij (subsidium) duke mos pretenduar të kryhet gjithçka 'nga lart'.

b) Shteti pranon veprimtarinë e Kishës katolike në shoqëri civile.

Misioni kryesor i Kishës është Ungjillëzimi, d.t.th. për të komunikuar Lajmin e mirë: dashurinë e Perëndisë të manifestuar në Jezu Krishtin që shpëton njeriun, duke u bërë fëmijë të Hyjit, të aftë për të dashur me të vërtetë, (madje edhe armiqtë

Vijon në fq. 8

SHKOLLA KATOLIKE NË SHQIPËRI

Vijim i fq. 7

e vet), dhe plot me shpresën e gëzueshme të jetës së përjetshme. Përtej kësaj detyre primare të Kishës, shtohen, si dy degë dytësore, por të rëndësishme dhe të vazhdueshme në historinë e Kishës: Arsimi dhe Shëndetësia. Historikisht s'ka diskutim se në Evropë arsimi dhe kujdesja për të së murët qenë një fushë në të cilen Kisha pati nismën parësore: të kujtohet lindja e spitalëve dhe të universitetëve nga "xenodokhia" dhe "studia generalia" kishtarë.

2/ Pikëpamja morale (kontributi mbi vlerat)

Arsimi katolik me shkollat e tij (nga kopshti në shkollë të mesme deri te universitetet katolike) ofron një "Propozim" vlerash të vlefshëm gjithashtu për një shoqëri laike. Kjo e fundit, që të jetë "e hapur" dhe e gjallë nuk duhet vetëm të promovojë një "tolerancë negative" (krh. laicizmi), por edhe vlerat pozitive, krijuese, dhe kjo është tmerrsisht urgjent në lidhjë me tundimet nihiliste të kulturës bashkëkohore (krh. statistikat mbi vetëvrasjet në botë: 800,000 në vit).

a) Vlerat fetare dhe njerëzore. Dashuria, Dinjteti, Vëllazëria.

Duke ndjekur Biblën, Kisha mëson se Perëndia është Dashuria. Vlera nr. 1 që Kisha përcjellë (edhe nëpërmjet arsimit katolik) është pikërisht dashuria. Që të duash Perëndinë si Atin, veten e vet si bir/bijë të dashur të Zotit dhe të gjithë të tjerët si vëllezër e motra. Kjo shpreh pozitivitetin më të lartë të jetës. Dy rrjedhojat e kesaj janë Dinjiteti dhe Vëllazëria. Dinjiteti i shenjt i personit (me fatin e tij të përjetshëm) dhe pra dashuria ndaj jetës. Nga ana tjetër, në nivelin social: Vëllazëria njerëzore. Është e qartë se këto dy vlera mund të ndihmojnë shumë për të kundërshtuar nihilizmin dhe individualizmin ekstrem që janë problemi kryesor i shoqërive të ashtuquajtura "të përparuara" (shih tragjedia demografike evropiane).

b) Vlerat që tregojnë ntegrimin mes Arsyes dhe Besimit.

Kisha katolike (sidomos pas dy Koncilëve të Vatikanit, 1870/ 1962-1965) dallon në mënyrë të qartë mes dy niveleve: Natyrës dhe Hirit, Fesë dhe Arsyes, Kishës dhe Shtetit. Kjo e siguron laicitetin e Shtetit dhe lirinë fetare. Prapëseprapë, vlerat antropologjike dhe sociale të cilat kisha promovon (dinjitet personal dhe vëllazëri njerëzore) janë të pranueshme dhe të arritshme edhe nga vetë aryeja dhe nga njerëz laikë (krh H. Bergson që pohonte se vetëm Vëllazëria me rrënjët e saja ungjillore mund të pajtojë Lirinë dhe Barazinë (që janë si dy motrat ndërluftuese), dhe të veprojë si shpirt i çiltër i solidaritetit të vërtetë.

3/ Pikëpamja historike (evropiane dhe shqiptare).

a) Kultura Evropiane.

Shqipëria është brenda Evropës. Qytetërimi evropian bazohet në 3 burime: Athina (mendimi kritik: "logos") - Romë (ligji romak: "ius") - Jeruzalem (besimi biblik: "agape"). Ky është ADN kulturore evropiane. Humanizmi katolik i shek. XV-XVI (Pico, Erasmus, Thomas More etj.) dëshmoi se ata mund të integrohen. Ata u rigjetën në etërit themelues të BE-së (Schuman, De Gasperi, Adenauer). Arsimi katolik është një mjet për të ruajtur dhe për të gjallëruar këtë trashgimin e trifishtë. Promovimi i arsimit katolik pra është një kontribut për integrimin e Shqipërisë në hapësiren evropiane si kulturë dhe qytetërim.

b) Rëndësia e intelektualëve katolikë në Shqipëri.

Gj. Fishta, Nik. Kaçorri, Ndr. Zadeja, Ndr. Mjeda, L. Gurakuqi...janë vetëm disa emrat që shprehin rolin e jashtëzakonshëm që Intelektualët katolikë kanë pasur në dobi të Kombit shqiptar. Kontributi kulturor i tyre për identitetin shqiptar është shenja më e qartë, se, që të pranosh vlerat dhe frymën e arsimit katolik nuk heq asgjë nga tiparet më pozitive të Shqipërisë, por i rrit dhe i forcon ato.

«Çfarë të keqeje i ka bërë feja kombit? Gjatë shekujve, deri në ditët tona, tri fetë kanë jetuar në harmoni duke dhuruar forca intelektuale në planin kultutor, moral dhe shpirtëror në dobi të fesë së popullit…

Feja është balsam për shpirtin dhe e çon njeriun kah udha e drejtë e Hyjit, kundër prishjes morale; me mësimet e saj krijon dinjitetin e jetës familjare dhe shoqërore për të mirën e popullit». (Dom Mikel Beltoja, Martir shqiptar i vitit 1974, fq. 87v; gjatë gjyqit me datën 07. 08. 1973)

Dom Lorenzo Rossetti

KARDINALI DOM ERNEST TROSHANI DHE IMZOT MASSAFRA NË BRESCIA -ITALI

Vijim i fq. 5

bashkësisë, e pastaj kremtoi Meshën e Shenjtë në Kishën e Brocos, ku i lumi Fausti është pagëzuar dhe është rritur. Të nesërmen, pra të shtunën më 14, mori pjesë në ndarjen e Çmimit Zemër Mike, Nobeli i misionarëve; edhe në atë rast, para dhënies së çmimit misionarëve të zgjedhur, dha një dëshmi të përvojës së tij misionare në kohët e vështira të burgut.

Imzot Massafra mori pjesë në të gjithë këtë veprimtari duke dhënë kështu dëshminë e një Kishe të gjallë që është duke rimarrë një ecje domethënëse edhe falë misionarëve që vazhdojnë të dhurohen në këtë tokë. Veçanërisht të premten në mbrëmje, më 13 tetor, Imzot Massafra mori pjesë në një tryezë të rrumbullakët së bashku me atë Federico Lombardi-n për të folur për të Lumin Fausti, kremtoi festën e pajtorit të një famullie të qendrës historike të qytetit, vizitoi don Silvio dhe don Michelangelo Braga-n në Bienno, dhe të dielën, më 15, kremtoi edhe ai Meshën në bashkësinë e Brozzo-s, vendlindje e të Lumit Fausti.

Dom Roberto Ferranti
(Drejtor i Zyrës për Dialogun Ndërfetar, Dioqeza e Brescia-s)

Vijon në fq. 8

NDËRROI JETË IMZOT SOTIR FERRARA
EPARK EMERITO

Me 25 nentor 2017 ndërroi jetë në Piana degli Albanesi Imzot Sotir Ferrara, Eparka Emerito, në moshën 80 vjeçare.
Në vijim letra e ngushëllimit.

Shkëlqesisë së Tij Imzot Giorgio Demetrio,
Epark– Piana degli Albanesi (Sicilia)

Dëshiroj t'ju shpreh ngushëllimet e mia për kthimin në shtëpinë e Atit të Eparkut Emerito, Shkël. Tij Imzot Sotir Ferrara. Vetëm më 19 të këtij muaji, pas kremtimit të Liturgjisë së Shenjtë, shkuam Ju dhe unë për t'i çuar Kungimin e Shenjtë.

Imzot Sotiri më njohu, dhe pasi që Ju i dhatë Kungimin e Shenjtë e para se të largoheshim, pata gëzimin ta bekoj.

Tani është ai që na bekon prej lart, ku kremton liturgjinë e amshuar të Qiellit në shoqërinë e të lumëve dhe nga ku me siguri do të vazhdojë ta shoqërojë ecjen e Kishës së Piana degli Albanesi.

Shkëlqesi, ngushëllime vëllazërore Juve dhe gjithë Klerit e besimtarëve.

Në bashkim feje dhe lutjeje ju përshëndes vëllazërisht.

Castellaneta, 27/11/2017

+ Angelo Massafra O.F.M.
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pultit
President i Konferencës Ipeshkvore

IMZOT ANGELO MASSAFRA MIDIS ARBËRËSHËVE NË PIANA DEGLI ALBANESI

Me 5 nëntor të vitit 2016 në katedralen e Shën Shtjefnit në Shkodër, u celebrua me madhështinë që u takon shenjtërve, mesha e shejtë me shpalljen e 38 të Lumët martirët e Shqipërisë: Mons. Vinçec Prenushi e 37 shokët e tij. Në atë gëzim morën pjesë edhe ipeshkvi i eparkisë së Piana Degli Albanesi, imzot Giorgio Dhemetrio Gallaro, bashkë me një prani të vogël të kishës arbëreshe të Siçilisë. Në atë rast ipeshkvi i Shkodrës Imzot Angelo Massafra, i bëri si dhuratë kishës arbëreshë nëpërmjet ipeshkvit të saj, reliket e 10 prej 38 martirëve të Shqipërisë. Këtë akt vëllazëror nga ana e ipeshkvit të Shkodrës, mund ta cilësojmë si misioni i martirëve ndaj vëllezërve të mërguar në shekuj. Ipeshkvi Giorgio Dhemetrio Gallaro, mbeti i mahnitur nga historia dhe forca e popullit shqiptarpër të gjithë vuajtet që pësoi gjatë regjimit komunist. Ai i bëri ftesë ipeshkvit të Shkodrës që sa më parë të bënte një vizitë në Eparkinë e Piana Degli Albanesi, sikur vëlai ndër vëllezër.

Me rastin e 80 vjetorit të lindjes së Eparkisë të Piana Degli Albanesi (tek Hora e Arbëreshëve) në zemër të Siçilisë, nga data 17 deri me 20 nëntor të vitit 2017, imzot Massafra, u ktheu vizitën vëllezërve arbëresh. Në ato ditë, Imzot Angelo Massafra, vizitoi gati të gjitha famullitë e fshatrave arbëreshe: Piana Degli Albanesi, Contessa Entelina, Santa Cristina Gela e Mezzojuso, të cilët e pritën me shumë gëzim e dëshirë të madhe për të ditur mbi martirët e Shqipërisë. I shoqëruar nga prifti më i ri i eparkisë papas Giuseppe Di Miceli (arbëresh), Imzot Massafra, solli mes të gjithëve nëpërmjet historisë dhe fesë së martirëve, forcën, bekimin dhe hirin e Trinisë së Shenjtë. Emocionet pushtonin zemrat e të gjithë, fëmijëe të rritur që merrnin pjesë në celebrimet dhe tregimet e imzot Massafrës, deri në pikën ku grupi i katekistëve të fshatit Santa Cristina, ka zgjedhur si mbrojtësen e tyre në ecjen shpirtërore, të lumen Marie Tuci. Kështu shkruajnë: "Fjalët e Imzot Angelo Massafrës, na kanë prekur zemrat. Martirët e Shqipërisë, kanë zgjuar në ne një zell të madh për identitetin tonë të krishterë; në vecanti, feja dhe forca e Marie Tucit na ka rrëmbyer zemrat, dhe e kemi zgjedhur si shembull për jetën".

Emocione të forta jetoi edhe Imzot Angelo Massafra, për mikpritjen vëllazërore që përjetoi mes arbëreshëve, në vecanti kur arriti në fshatin Mezzojuso dhe tek hyrja e kishës së Shenkollit e priten disa fëmijë me kryqin dhe me flamurin shqiptar në dorë. Këto dy imazhe nuk bëjnë tjetër përveç se të sjellin në mendje fjalët me të cilat të lumët martirë shqiptarë fituan me jetën e tyre mbi vdekjen: "Rroftë Krishti Mbret e rroftë Shqipëria!"; këto fjalë të arta e plot fe për Zotin dhe Atdheun, kanë shënuar cdo zemër dhe mendje në të cilat kanë zënë vend.

Jehona që ushton akomasot mbas kësaj vizite në zemrat e arbëreshëve, është: " Mirë se të vish përsëri vëllai ynë i dashur shqiptar".

Motër Micaela Toma

DRAMA E SË LUMES MARIE TUCI NË ORIA-ITALI

Meqë tetori është muaji kushtuar misioneve, dioqeza e Orias na ftoi me dashurinë e saj më të madhe edhe ne të rinjtë e famullisë së Shën Rrokut Rranxa-Bushat që të merrnim pjesë në një sëri aktivitetesh të tyre të vjeshtës ku, si famulli, do të paraqisnim dramën e së Lumes Marie Tuci. Ishim shumë të entuziazmuar që na u besua një mision i tillë, si edhe se do bënim të gjithë një udhëtim së bashku, gjatë të cilit do zinim edhe shoqëri të re.

Me datën 19 tetor ne arritëm në Itali dhe u pritëm nga famullia e Avetranas-Taranto. Ishte me të vërtetë një pritje e ngrohtë dhe plot dashuri. Kjo ishte edhe arsyeja se përse ne filluam të ndjeheshim si në shtëpinë tonë që në minutat e parë që arritëm aty.

Pasi drekuam të gjithë bashkë, do të vinte koha që të shpërndaheshim nëpër familjet tona, ku na kishin caktuar, familje të cilat ishin një mrekulli e vërtetë. Të gjithë pjesëtarët e familjes percillnin një dashuri aq të madhe saqë dukej sikur kishe një jetë që jetoje me ta. Pasdite do vinte orari që të gjithë të mblidheshim sërish që të njihnim më mirë njëri-tjetrin dhe sigurisht, ajo që ishte më e rëndësishmja, të luteshim e të kuptonim më mirë rëndësinë e Zotit dhe të dashurisë së tij.

Dita tjetër na priste me misione të reja që do të ishin në dobi të një pjesë të qytetarëve të Avetranas. Shkuam të vizitonim të moshuarit e kësaj qyteze. Vizita jonë në shtëpitë e këtyre persona ishte me të vërtetë shumë e rëndësishme dhe mund ta kuptoje vetëm me një shikim që ata donin të të falënderonin.

Pas një pasditeje të bukur do të vinte orari i drekës dhe do të hanim të gjithë bashkë ushqimet e përgatitura nga anëtarët e familjeve që na kishin mikpritur. Pas çdo misioni që ne kryenim, gjithmonë miqtë tanë italianë gjenim kohë edhe për një shëtitje me ne që të mund të shoqëroheshim më shumë me njëri-tjetrin.

Me daten 21 tetor do të shfaqnim dramën e së Lumes Marie Tuci prandaj që në orët e para të mëngjesit do fillonin provat dhe përgatitjet për këtë shfaqje. Pasditen e kësaj date, të gjithë ne do të ishim pjesë e një aktviteti të organizuar nga Karitasi i dioqezës së Orias. Para se të shpëndaheshim nëpër qytezë, ipeshkvi i Orias Imzot Vinenzo Pisanello bëri një lutje së bashku me të gjithë të pranishmit dhe na nxiti të shkonim te secila familje me përzemërsi e dashuri ashtu si Krishti na ka mësuar. Nuk vonuam dhe të gjithë u shpërndamë në grupe për të mbledhur ndihma për të varfrit dhe, ajo çfarë na bënte përshtypje, ishte se pothuajse në çdo shtëpi gjenim mikpritjen e njerëzve që kishin bërë gati tashmë gjërat që donin të na dhuronin për të varfrit. Në darkë do të shfaqnim dramen për të cilën edhe ishim ftuar. Të gjithë ishim shumë të emocionuar dhe pyesnim veten se si do t'u dukej miqve tanë të rinj realiteti i hershëm shqiptar që

do të paraqisnim përmes kësaj shfaqjeje. Dramën e interpretuam me një emocion të madh sepse, në vërtetë, u bëmë pjesë e saj dhe, jo vetëm ne, por edhe miqte tanë italiane që kishin mbushur kishën e Avetranas. Dramën ne e shfaqëm në gjuhën shqipe, por gjithçka ishte e përkthyer me titra në italisht dhe ishte lehtësisht e kuptueshme për të pranishmit.

Ishte një sukses i vërtetë sepse u arrit ajo çfarë ne donim të përcillnim rreth dëshmisë heroike të së Lumes Marie Tuci. Në fjalët e tyre përshëndetëse famullitari Don Giovanni Dimauro dhe drejtori i karitasit të Orias Dom Alessandro Mayer u shfaqën shumë të prekur e të mallëngjyer nga përmbajtja e shfaqjes. Këto ditë që ne kaluam në famullinë e Avetranas, ishin magjepsëse sepse u ndiemë të gjithë me të vërtetë pjesë e një misoni që do të ishte në dobi të të gjithëve.

Na u dhuruan këto ditë kujtime të paharrueshme dhe, a e dini se çfarë na u dhurua tjetër? Na u dhurua një familje e dytë.

Etleva Lleshi

LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

SHUGURIMI DIAKONAL I SEMINARISTIT ZEF MARKU

Dita e shtunë, më 28 tetor 2017, është përshkuar nga një atmosferë lutjeje dhe përshpirtërie, në Katedralen e Shën Terezës së Kalkutës, në Vau-Dejës. Aty u mblodhën shumë besimtarë të ardhur nga vende të ndryshme të territorit të Dioqezës së Sapës, meshtarë e motra, familjarë dhe miq, për të bashkëndarë gëzimin e seminaristit Zef Marku, i cili mori urdhërin e diakonatit. Këtë moment të rëndësishëm drejt rrugës së meshtarisë, e shoqëroi me vendosjen e duarve të Shkëlqesisë së tij, Ipeshkvi i Sapës, Imzot Simon Kulli, i cili fillimisht tha se kemi arsye për të shprehur gëzimin së bashku me psalmistin duke thënë: "Sot është dita që na e dhuroi Zoti". Më pas ipeshkvi në homelinë e rastit vuri theksin mbi rëndësinë e shugurimit diakonal, që do të thotë shërbëtor. "Në pjesën e Ungjillit që sapo dëgjuam na paraqitet në mënyrë të qartë se, si Zoti ynë Jezu Krishti tërhiqej herë pas here në mal për t'u lutur. Ungjilli i sotëm thekson se Jezusi kalon natën duke ju lutur Hyjit, dhe pas kësaj marrëdhënieje të ngushtë me Atin e vet në të zbardhur të dritës thërret dishepujt e vet, dymbëdhjetë ndër të cilët edhe Shën Simonin dhe Shën Juden e Jakobit të cilët Kisha shenjte i Kremton sot.

Në përfundim, imzot Simoni iu drejtua Zefit duke i thënë: Bir fort i dashur që po e merr urdhrin e diakonatit, ne të gjithë, së bashku me ty i lutemi Zotit që të ta dhurojë hirin e duhur për të kuptuar madhështinë dhe bukurinë e asaj që po fillon dhe për t'iu përgjigjur me bujari, përvujtëri dhe përkushtim kësaj thirrjeje që bëhet mision në emër të Kishës. Kujtohu gjithmonë se emri yt dhe fytyra jote ishte në mendjen dhe zemrën e Jezusit ndërsa Ai po lutej në mal, edhe thirrja jote sikurse ajo e dishepujve është fryt i atyre netëve që Jezusi ka jetuar në lutje me Atin e vet.

Menjëherë pas homelisë u mbajt riti i shugurimit diakonal, përmes të cilit i zgjedhuri dënjohet të pranohet në urdhrin diakonal, duke u zotuar me premtimet që kisha nënë i parashtron.

Në fund, diakoni i saposhuguruar Zef Marku mori fjalën dhe tha: falënderoj përzemërsisht të gjithë të pranishmit, që duke marrë pjesë në gëzimin e shugurimit tim si diakon i keni dhuruar ngjyrë të veçantë kësaj ditë. Faleminderit shumë ipeshkvinjve të mi, eprorëve dhe edukatorëve, kolegëve të mi për afërsinë, mbështetjen dhe kurajon që me keni dhanë në ecjen time në seminar. Më keni përcjellë gjatë formimit tim shpirtëror e intelektual. Keni qenë një pikë mbështetje për të gjitha vështirësitë dhe gëzimet e mia. Lavdi, falënderim dhe nder i qoftë Hyjit, Atit të Zotit tonë Jezu Krishtit në Shpirtin Shenjt për Hiret dhe Bekimet që ndau dhe ndan në jetën time, sidomos sot kur Hiri i tij më lartësoi në rendin e diakonit që përmes kësaj shërbesë të behem shëmbëllesë më e gjallë e Krishtit Zot.

DOM MARK SHTJEFNI MERR DETYRËN E FAMULLITARIT NË VAU – DEJËS

Në të kremten e të dieles së XXXI gjatë vitit, datë 05. 11. 2017, përveç përkujtimit të një vjetorit të Lumturimit të Martirëve Shqiptarë të Kishës Katolike, bashkësia famullitare e Shën Nikollit e bashkuar në lutje jetoi një moment gëzimi të veçantë, pasi Ipeshkvi i vendit, Imzot Simon Kulli shpalli zyrtarisht famullitarin e ri të Katedrales në Vau –Dejës, në personin e dom Mark Shtjefnit, një ngjarje kjo mjaft e rëndësishme në jetën e bashkësisë.

Dom Mark Shtjefni është ndër meshtarët me përvojë të gjatë baritore dhe akademike, i cili gëzon 13 vite jetë meshtarake.

Në praninë e ipeshkvit dhe besimtarëve të pranishëm dom Marku bëri betimin përmes të cilit mori angazhimin e tij të plotë për të kremtuar me devocion e besnikëri misteret e Krishtit, sipas traditës së Kishës; për të predikuar Ungjillin dhe mësimin e fesë Katolike; për të qenë një at shpirtëror i kësaj bashkësie duke formuar kështu një familje të vetme të bashkuar në fe, shpresë e dashuri.

Edhe në fjalën e rastit, imzot Simoni theksoi rëndësinë dhe rolin e famullitarit. Ai ftoi besimtarët që famullitarin, që ka detyrën dhe pushtetin prej vetë themeluesit të meshtarisë Jezu Krishtit, ta duan, ta pranojnë me mësimet e tij që i shpall në emër të Krishtit, duke u rritur kështu së bashku në fe për shëlbimin e gjithësecilit.

Këtë grigjë që po të besohet ty Dom Mark, tha mes të tjerash ipeshkvi, po ta besoj në kujdes që t'i ushqesh me Fjalën e Zotit t'iu ndash Sakramentet dhe bekimet që kanë nevojë; t'i mësosh dhe edukosh në mësimin e Krishtit dhe të Kishës. Zoti të bekoftë dom Marku!

Violeta Marashi

Me arbëreshët

Piana degli Albanesi



A.P.R.M.

Në vitin e Zotit 2017, më 5 nëntor,
me rastin e përvjetorit të parë të Lumnimit të
Imzot Vinçenc Prennushit me 37 Shokë Martirë,
Arqipeshkvi Metropolitan i Shkodër-Pult
Imzot Angelo Massafra O.F.M.,
mirënjohës ndaj Zotit të Gjithëpushtetshëm
për dhuratën e madhe të këtyre heronjve të fesë
kujton Martirët e Lumë që kanë banuar
në këtë Arqipeshkvi Metropolitane:

Dom Lazër Shantoja
Dom Luigj Prendushi
Dom Ndre Zadeja
Dom Anton Muzaj
Dom Marin Shkurti
Dom Mikel Beltoja

Qoftë bekuar kujtimi i tyre
dhe ndërmjetësimi i tyre i përbashkët
fitoftë prej Trinisë së shenjtë çdo hir shpirtëror.

Pllakati i vendosur në hyrjen e Arqipeshkvisë

Piana degli Albanesi

Piana degli Albanesi

Santa Cristina

HAPËSIRË MEDIATIKE

Regjistrohu në kanalin tone!

NgjarjetKishaKatolikeShkoderPult

**Do të gjesh video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës**

Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqosja
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë